



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

V E N D I M

**PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS ANKIMORE NR. 58 TË PARTISË KOMBËTARE
KONSERVATORE ALBANIA, ME OBJEKT "SHPALLJEN E PAVLEFSHME TE ZGJEDHJEVE
NË QV NR. 0686, QV NR. 0791, QV, 07141, QV NR. 07142, QV NR. 07171, QV NR.
07294, QV NR. 0740, QV NR. 07403, QV NR. 0727, QV NR. 0770, QV NR. 0705" PËR
KRYETAR TË BASHKISË LEZHË.**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në mbledhjen e datës 12.07.2017, me pjesëmarrjen e:

| | | |
|---------|-----------|------------|
| Klement | ZGURI - | Kryetar |
| Denar | BIBA - | Zv.Kryetar |
| Bledar | SKËNDERI- | Anëtar |
| Edlira | JORGAQI- | Anëtare |
| Rezarta | BITRI- | Anëtare |

Shqyrtoi çështjen me

KËRKUES: Partia Kombëtare Konservatore Albania.

Palë e interesuar: Partia Socialiste e Shqipërisë.

OBJEKT: Shqyrtimi i kërkesës ankimore nr.58 me objekt kundërshtimin e vendimit të KQZ-së, nr.522, datë 04.07.2017 "Shpalljen e pavlefshme të zgjedhjeve në QV nr. 0686, QV nr. 0791, QV nr.07141, QV nr. 07142, QV nr. 07171, QV nr. 07294, QV nr. 0740, QV nr. 07403, QV nr. 0727, QV nr.0770, QV nr. 0705" për kryetar të bashkisë Lezhë.



BAZË LIGJORE: Neni 21, pika 1, neni 23, pika 1, gërma a, neni 116, 117, 118, 119, 122, 123/3, 124, 126, 133, 138, 141, 143, 160, 161 të ligjit Nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë"

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur dhe dëgjoi diskutimet e të pranishmëve:

V Ë R E N

Partia Kombëtare Konservatore Albania në datë 08.07.2019 ka depozituar pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, kërkesën ankimore nr. 58 me objekt: "Shpalljen e pavlefshme të zgjedhjeve në QV nr.0686, QV nr.0791, QV nr.07141, QV nr.07142, QV nr.07171, QV nr. 07294, QV nr. 0740, QV nr. 07403, QV nr. 0727, QV nr.0770, QV nr.0705" për kryetar të Bashkisë Lezhë.

Në përputhje me nenet 134 e vijues të Kodit Zgjedhor, në seancën plenare të datës 11.07.2019, ora 15:00, zhvilloi shqyrtimin administrativ të kërkesës ankimore me rend dite: Shqyrtimin e kërkesës ankimore nr. 58 regj., të Partisë Kombëtare Konservatore Albania me objekt "Shpalljen e pavlefshme të zgjedhjeve në QV nr. 0686, QV nr. 0791, QV nr.07141, QV nr. 07142, QV nr. 07171, QV nr. 07294, QV nr. 0740, QV nr. 07403, QV nr. 0727, QV nr.0770, QV nr. 0705" për kryetar të bashkisë Lezhë"

KQZ, pasi verifikoi pjesëmarrjen e ankuesit, mori në shqyrtim kërkesën e paraqitur nga Partia Socialiste e Shqipërisë, për të marrë pjesë në shqyrtimin e ankimit administrativ të kërkesës ankimore nr.58 si palë e interesuar dhe pasi i çmoi këto kërkesa në përputhje me nenin 133, pika 1, 2 dhe 3, të ligjit Nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, vendosi pranimin e Partisë Socialiste si palë të interesuar në këtë proces.

KQZ në përfundim të verifikimit të legjitimitetit procedural të palëve ftoi ankuesin e më pas palën e interesuar, të paraqesin pretendimet dhe prapësimet e tyre.

Pala ankuese *Partia Kombëtare Konservatore Albania*, e përfaqësuar në seancë nga Z. Olsi Vasiu dhe z. Armand Shkurta të ftuar në seancë nga Kryetari i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, për të dhënë shpjegime rreth kërimit të paraqitur, parashtroi se:



Partia Kombëtare Konservatore Albania mori pjesë si subjekt politik në zgjedhjet për kryetar të bashkisë Lezhë dhe paraqiti si kandidat të saj z. Eduart Mark Ndocaj.

Referuar nenit 123/5 të ligjit Nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, ankuesi, Partia Kombëtare Konservatore Albania, në pretendimet e saj, sikurse parashton në kërkesën ankimore nr. 58 , kundërshton vendimin e KQZ Nr. 948 datë 05.07.2009, "Për nxjerrjen e rezultatit të votimit për zgjedhjen e kryetarit të bashkisë Lezhë, në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 Qershor 2019" si dhe vendimin nr. 104 datë 02.07.2019 të KZAZ nr. 12 dhe vendimin nr. 173 datë 02.07.2019 të KZAZ-së nr. 13.

Ankuesi pretendon se në shumë qendra votimi nga procesverbalet përkatëse kanë rezultuar më shumë vota të gjendura në kutitë e votimit se sa numri i zgjedhësve që kanë marrë pjesë. Kjo shkelje sipas ankuesit përbën shkelje të rëndë të ligjit që ka cënuar në mënyrë të pariparueshme procesin zgjedhor duke bërë shkak për shpalljen e pavlefshme të zgjedhjeve në këta qendra votimi. Sipas ankuesit në qv e mëposhtme rezultojnë se :

KZAZ nr. 12 QV 0686 kanë votuar 52 vetë por fletë të gjetura në kuti janë 53
KZAZ nr. 12 QV 07091 kanë votuar 127 vetë por fletë të gjetura në kuti janë 128
KZAZ nr. 12 QV 07141 kanë votuar 162 vetë por fletë të gjetura në kuti janë 163
KZAZ nr. 12 QV 07142 kanë votuar 164 vetë por fletë të gjetura në kuti janë 166
KZAZ nr. 12 QV 07171 kanë votuar 141vetë por fletë të gjetura në kuti janë 142
KZAZ nr. 12 QV 07294 kanë votuar 215 vetë por fletë të gjetura në kuti janë 216
KZAZ nr. 12 QV 0740 kanë votuar 203 vetë por fletë të gjetura në kuti janë 223
KZAZ nr. 12 QV 07403 kanë votuar 148 vetë por fletë të gjetura në kuti janë 149
KZAZ nr. 13 QV 0727 kanë votuar 138 vetë por fletë të gjetura në kuti janë 139
KZAZ nr. 13 QV 0770 kanë votuar 70 vetë por fletë të gjetura në kuti janë 69
KZAZ nr. 13 QV 0705 kanë votuar 67 vetë por fletë të gjetura në kuti janë 68

Ankuesi pretendon se si pasojë e këtyre shkeljeve dhe në mënyrë kaq evidente është cënuar parimi i numërimit të votave që e bëjnë të pa evitueshëm rinumërimin e tyre dhe procesin e hapjes së të gjitha kutive. Duke qënë se pavlefshmëria e 11 qendrave të votimit do të sillte ndryshimin e rezultatit si dhe të tabelës përmbledhëse dhe vendimet që janë objekt ankimi duhet të ndryshohen.

Pala e Interesuar Partia Socialiste e përfaqësuar në seance nga z. Eridian Salianji mbështeti



kërkesën e paraqitur për rinumërimin e këtyre QV, për t'u shqyrtuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve për të bërë sa më transparent procesin.

Pas paraqitjes së pretendimeve të palëve, për nevoja të hetimit administrativ, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve vendosi të administrojë si prova Librin e Protokollit të Mbledhjeve, Proces-Verbalet e Konstatimit, të KZAZ nr. 12, KZAZ nr. 13, tabelat e rezultatit të grupeve të numërimit për QV të e cituara në ankim.

Në analizë të provave, peretendimeve dhe kërkesave të palëve në proces Komisioni Qendror i Zgjedhjeve vlerëson se:

Kërkesa për rinumërim dhe rivlerësim, në mbështetje të nenit 138 të Kodit Zgjedhor, duhet të mbështet në prova të cilat pasqyrojnë se gjatë procesit të numërimit dhe vlerësimit të votave sipas përcaktimeve të nenit 116, 119 të Kodit Zgjedhor ka patur shkelje të konstatuara për numërim jo të saktë të votave për çdo subjekt zgjedhor, ose gjatë vlerësimit të votave ka patur kundërshtim nga ndonjë prej anëtarëve të grupeve të numërimit apo vëzhguesve të subjekteve zgjedhore. Po sipas procedurave të përcaktuara në nenin 116, pika 6 dhe 118 të Kodit Zgjedhor këto kontestime duhet të pasqyrohen në dokumentacionin zgjedhor si kundër është Procesverbali i Konstatimit dhe Libri i Protokollit të mbledhjeve të KZAZ-së. Në këtë rast, votat e kontestuara, në mbështetje të nenit 118 të Kodit Zgjedhor, duhet të futen në zarfin e fletëve të votimit të kontestuara. Nga hetimi i dokumentacionit zgjedhor nuk ka asnjë shënim në Librat e Protokollit të Mbledhjeve dhe Procesverbalin e Konstatimit, të KZAZ nr. 12 dhe KZAZ-së nr. 13. Gjithashtu në rastet e qendrave të votimit të cituara, në te cilat nuk perputhet me 1(një) numri i zgjedhësve që kanë votuar me numrin e fletëve të votimit të gjetura në kuti, rezulton se në këto raste sipas tabelës përmbledhëse të rezultatit ka 1 (një) fletë votimi të hedhur gabim Megjithatë provat e paraqitura nga pala ankuese, sipas të ciles të paktën për QV nr. 0740 në tabelën përmbledhëse të rezultatit të KZAZ-së nr. 13, kanë votuar 203 vetë por fletë të gjetura në kuti janë 223 dhe fletë të hedhura gabim 0, mund të shërbejë si indicie për thellim të hetimit administrativ, me rinumërimin dhe rivlerësimin e votave.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve vlerësoi se transparenca në lidhje me numërimin dhe vlerësimin e votave për zonën zgjedhore qarku Lezhë ka një rëndësi të madhe për besueshmërin e procesit zgjedhor dhe për integritetin e tij. Për sa koha ankuesit kanë dyshim se në disa qendra votimi objekt ankimi, vota nuk është vlerësuar saktë, referuar faktit të mosrakordimit të rezultatit për një qendër votimi, nevoja për transparencë të procesit të numërimit për këto Qendra Votimi, bindi dy anëtarë të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve të kërkojnë marrjen e provave për të



vërtetuar faktet e paraqitura nga ankuesit nëpërmjet rinumërimit dhe rivlerësimit të votave në kutitë e votimit të qëndrave të votimit sipas parashkrimeve të ankuesve. Në përputhje me parashikimet e nenit 136, pika 3 të Kodit Zgjedhor, ku parashikohet shprehimisht se: "Kërkesa për marrjen e provave, sipas shkronjës "c" të pikës 1 të këtij neni, kur mbështetet nga dy anëtarë të KQZ-së dhe kur këto prova administrohen vetëm nga KQZ-ja, pranohet menjëherë pa iu nënshtruar debatit ose votimit në KQZ. KQZ-ja është e detyruar të procedojë menjëherë me marrjen dhe shqyrtimin e provave të kërkuara", dhe në përputhje me parashikimet e nenit 138 "Këqyrja e materialit zgjedhor" të Kodit Zgjedhor, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me vendim të ndërmjetëm vendosi të kryejë rinumërimin dhe rivlerësimin e votave në QV nr.0686, QV nr.0791, QV nr.07141, QV nr.07142, QV nr.07171, QV nr. 07294, QV nr. 0740, QV nr. 07403, QV nr. 0727, QV nr.0770, QV nr.0705 sipas objektit të ankimit dhe mori masat për zhvillimin e procedurave në përputhje me nenin 138 të Kodit Zgjedhor.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, duke respektuar procedurat e parashikuara në Kodin Zgjedhor, realizoi në prani të palëve në proces dhe të publikut, rinumërimin e fletëve të votimit të ndodhura respektivisht në kutitë e votimit të QV sipas objektit të kërkesave ankimore.

Nga rinumërimi dhe rivlerësimi i votave rezultoi se:

- Në Qendrën e Votimit 07141, kandidati i propozuar nga Partia Kombëtare Konservatore Albania z. Eduart Mark Ndocaj nga 14 vota ne tabelën përmbledhëse të rezultatit u vlerësuan nga rinumërimi 15 vota dhe kandidati i propozuar nga Koalicioni Aleanca për Shqipërinë Europiane, z. Pjerin Zef Ndreu nga 118 vota ne tabelën përmbledhëse të rezultatit u vlerësuan nga rinumërimi 117 vota.
- Në Qendrën e Votimit 0705, kandidati i propozuar nga Partia Kombëtare Konservatore Albania z. Eduart Mark Ndocaj nga 2 vota ne tabelën përmbledhëse të rezultatit u vlerësuan nga rinumerimi 5 vota dhe kandidati i propozuar nga Partia Bindja Demokratike, z. Salvador Pretash Kaçaj nga 5 vota ne tabelën përmbledhëse të rezultatit u vlerësuan nga rinumerimi 2 vota.

Nga shqyrtimi administrativ i provave dhe i fakteve nuk rezultoi të kishte asnjë lloj shkelje të tillë në masën që të shpallen të pavlefshme zgjedhjet në qendrat e votimit QV nr.0686, QV nr.0791, QV nr.07141, QV nr.07142, QV nr.07171, QV nr. 07294, QV nr. 0740, QV nr. 07403, QV nr. 0727, QV nr.0770, QV nr.0705.

Subjekti ankues kërkon pavlefshmërinë e zgjedhjeve në në qendrat e sipërpërmendura dhe e mbështet ankimin në bazën ligjore përveçse neneve 124, 125, 126 në nenin 160 dhe nenin 161 që lidhen posaçërisht me pavlefshmërinë e zgjedhjeve. Neni 160, pika 1 konkretisht parashikon

5



Nr. 1088 e Vendimit Data 12.07.2019 e Vendimit Ora 10.00 e Vendimit

Shqyrtimi i kërkesës ankimore nr.58 me objekt kundërshtimin e vendimit të KQZ-së, nr.522, datë 04.07.2017 "Shpalljen e pavlefshme të zgjedhjeve në QV nr. 0686, QV nr. 0791, QV nr.07141, QV nr. 07142, QV nr. 07171, QV nr. 07294, QV nr. 0740, QV nr. 07403, QV nr. 0727, QV nr.0770, QV nr. 0705" për kryetar të bashkisë Lezhë.

pavlefshmërinë e zgjedhjeve në qendrën e votimit. Konkretisht neni 160, pika 1 parashikon se Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, kryesisht ose me kërkesë të subjekteve zgjedhore i shpall zgjedhjet të pavlefshme në një apo më shumë qendra votimi në rast se:

- a) Ka ndodhur shkelje të ligjit të cilat kanë çënuar rëndë procesin zgjedhor ose kur tërësia e shkeljeve të ligjit sipas kësaj shkronje të ndodhura në ato qendra votimi mund të ketë çënuar procesin zgjedhor në një masë të tillë që mund të ketë ndikuar në ndarjen e mandateve në zonën zgjedhore.
- b) Ka ndodhur fatkeqësi natyrore në përmasat të tilla që kanë penguar pjesmarrjen e zgjedhësve në votim ose :
- c) Votimi nuk ka filluar apo është pezulluar për më shumë se 5 orë.

Subjektet zgjedhor në përputhje me rregullat dhe afatin e përcaktuar në nenin 124 të Kodit Zgjedhor kanë të drejtë të kërkojnë në KQZ shpalljen e pavlefshmërisë së zgjedhjeve në qendra votimi të caktuara. Kërkesa për shpalljen e pavlefshme të zgjedhjeve duhet të përmbajë shkaqet ligjore, përshkrimin e rasteve të shkeljeve dhe arsyetimin e detajuar për pasojën e tyre. Këto detyrime ligjore nuk rezultojnë në ankimin e paraqitur nga ankuesi.

Do të konsiderohet ndikim në ndarjen e mandateve kur numri i zgjedhësve që kanë votuar apo mund të kishin votuar në qendrën apo qendrat e votimit të shpallura të pavlefshme është i barabartë ose më i madh se numri i zgjedhësve të nevojshëm për caktimin e një mandati në zonën zgjedhore përkatëse mbi bazën e përlogaritjes së votave të vlefshme në zonën zgjedhore të bërë sipas nenit 162 Kodit Zgjedhor. Përsëritja e zgjedhjeve urdhërohet në të njëjtin vendim të KQZ-së që i shpall ato të pavlefshme. Zgjedhjet për këshillat e qeverisjes vendore nuk përsëriten.

Referuar faktit se diferenca ndërmjet numrit të votave dhe pas rinumërimit të tyre, të kandidatit të propozuar nga Partia Kombëtare Konservatore Albania z. Eduard Ndocaj me Kandidatin fitues z. Pjerin Zef Ndreu është 12135 vota rezulton se nuk ka asnjë shkelje të ligjit e cila të ketë ndikim në ndarjen e mandateve.

Nga analiza ligjore e provave të administruara gjatë shqyrtimit administrativ, pretendimeve dhe prapësimeve të palëve në këtë proces, KQZ-ja konstaton se kërkesat ankimore e paraqitur nga Partia Kombëtare Konservatore Albania , është e pabazuar në prova dhe në ligj.



PËR KËTO ARSYE

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, për gjithë sa më sipër, mbështetur në nenin 21, pika 1, nenin 23, pika 1, germa "a", nenin 124, 132 e në vijim nenin 143, pika 1, germa b, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë" të ndryshuar,

V E N D O S I:

1. Lënie në fuqi të vendimit të KQZ me nr. 948, datë 05.07.2019 " Për nxjerrjen e rezultatit të votimit për zgjedhjen e kryetarit të bashkisë Lezhë, në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 Qershor 2019".
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor, pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, brenda 5 ditëve nga shpallja e tij.

| | | |
|----------------|------------------|-------------------|
| Klement | ZGURI - | Kryetar |
| Denar | BIBA - | Zv.Kryetar |
| Bledar | SKËNDERI- | Anëtar |
| Edlira | JORGAQI- | Anëtare |
| Rezarta | BITRI- | Anëtare |

